

Përmbledhje

Ekonomia e Kosovës në tremujorin e parë 2015 (TM1 2015) shënoi rritje vjetore prej 0.22 përqind dhe një rritje vjetore prej 3.37 përqind në TM2 2015 (ASK, 2015). Parashikimet e BQK-së për vitin 2015 sugjerojnë rritje ekonomike prej 3.5 përqind, krahasuar me rritjen prej 1.2 përqind sa ishte në vitin 2014.

Çmimet kanë vazhduar të shënojnë rënie. Deri në shtator 2015, Kosova është karakterizuar me deflacion prej 0.6 përqind, krahasuar me inflacionin prej 0.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Spektori fiskal gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015 u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Sa i përket të hyrave buxhetore, është shënuar rritje më e lartë e të hyrave vendore, përderisa në kuadër të shpenzimeve, rritja e kategorisë së pagave e mëditjeve dhe kategorisë së subvencioneve e transfereve ka ndikuar që shpenzimet e përgjithshme qeveritare të shënojnë rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, sektori i jashtëm është karakterizuar me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale. Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse kryesisht i atribuohet rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së shërbimeve dhe të ardhurave parësore dhe dytësore. Deri në shtator 2015, eksportet shënuan rritje prej 5.6 përqind, përderisa importet u

karakterizuan me rritje prej 2.9 përqind. Aktiviteti ekonomik në nëntë muajt e parë të vitit 2015 është mbështetur edhe nga dy burime të rëndësishme të rritjes ekonomike në vend, remitencat dhe IHD-të.

Spektori bankar deri në shtator 2015 është karakterizuar me përshpejtim të rritjes së aktivitetit kreditor, ku vlera e përgjithshme e kredive shënoi rritje vjetore prej 7.5 përqind (3.2 përqind në shtator 2014). Rritje shënuan edhe depozitat me një normë vjetore të rritjes prej 5.5 përqind, por që është më e ulët krahasuar me rritjen prej 7.4 përqind të regjistruar në shtator 2014.

Normat e interesit në kredi dhe depozita kanë vazhduar të ndjekin trend rënës, megjithëse për dallim nga periudhat paraprake, rënia ishte më e shprehur për interesin në kredi. Në shtator 2015, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua në 7.9 përqind (10.7 përqind në shtator 2014), përderisa norma mesatare e interesit në depozita u zvogëlua në 0.9 përqind (1.1 përqind në shtator 2014). Spektori bankar gjithashtu u karakterizua me përmirësim të cilësisë së portofolit kreditor, ku në shtator 2015 pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kreditë u zvogëlua në 6.8 përqind (8.5 përqind në shtator 2014). Niveli kapitalizimit dhe i likuiditetit të sektorit ishte i kënaqshëm në shtator 2015 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	04
Ekonomia e Kosovës	05
Sektori Real	05
Sektori Fiskal	08
Sektori i Jashtëm	09
Sistemi Financiar	11
Sektori Bankar	11
Sektori Pensional	21
Sektori Mikrofinanciar	22
Sektori i Sigurimeve	25
Tregu i Letrave me Vlerë	26

GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së	04
Figura 2. Rritja reale e PBB-së	05
Figura 3. Norma e inflacionit	06
Figura 4. Lëvizja e çmimeve sipas komponentëve	06
Figura 5. Indekset e çmimit të konsumit, prodhimit dhe importit	06
Figura 6. Regjistrimi i bizneseve	07
Figura 7. Struktura e ndërmarrjeve të reja	08
Figura 8. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar	09
Figura 9. Remitencat	10
Figura 10. Struktura e investimeve të huaja direkte	10
Figura 11. Asetet e sistemit financiar	11
Figura 12. Asetet e sektorit bankar	11
Figura 13. Ecuria e kredive dhe depozitave	12
Figura 14. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare	12
Figura 15. Kreditë sipas sektorëve ekonomik	13
Figura 16. Ndryshimi vjetor i kredive sipas sektorëve ekonomik	14
Figura 17. Kreditë sipas afatit të maturimit	14
Figura 18. Depozitat	15

Figura 19. Struktura e depozitave -----	15
Figura 20. Struktura e depozitave sipas maturimit -----	16
Figura 21. Depozitat e afatizuara -----	16
Figura 22. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita -----	17
Figura 23. Norma mesatare e interesit në kreditë e ndërmarrjeve -----	17
Figura 24. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	18
Figura 25. Norma mesatare e interesit në kreditë e ekonomive familjare -----	18
Figura 26. Norma mesatare e interesit në depozita -----	18
Figura 27. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	20
Figura 28. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	20
Figura 29. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore -----	20
Figura 30. Ndryshimi vjetor i gjithsej kredive dhe kredive joperformuese -----	21
Figura 31. Asetet e sektorit pensional -----	21
Figura 32. Asetet e sektorit mikrofinanciar, në milionë euro -----	22
Figura 33. Asetet e sektorit mikrofinanciar, në përqindje -----	22
Figura 34. Kreditë e sektorit mikrofinanciare sipas sektorëve ekonomik -----	23
Figura 35. Kreditë e sektorit mikrofinanciare sipas maturitetit -----	24
Figura 36. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	24
Figura 37. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	25
Figura 38. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	27
Figura 39. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit -----	27
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	29

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (<i>angl. Capital Adequacy Ratio: CAR</i>)
CHF	Franku Zvicerran (<i>angl. Swiss Franc: CHF</i>)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (<i>angl. Consumer Price Index: CPI</i>)
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro (<i>angl. Euro currency</i>)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik (<i>angl. The Pound Sterling</i>)
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit (<i>angl. Index Price Index: IPI</i>)
NPL	Kreditë Jopërfomuese (<i>angl. Non-Performing Loans: NPL</i>)
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (<i>angl. Return on Average Assets: ROAA</i>)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl. Return on Average Equity: ROAE</i>)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (<i>angl. Risk Weighted Assets: RWA</i>)
USD	Dollari Amerikan (<i>angl. United States Dollar</i>)
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor


Gjatë tremujorit të tretë 2015 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak, eurozona u karakterizua me ritëm të përshpejtuar të rritjes së aktivitetit ekonomik. Ekonomia e eurozonës shënoi rritje prej 1.6 përqind në TM3 2015 (0.8 përqind në TM3 2014). Ndërsa, krahasuar me tremujorin paraprak, norma reale e rritjes ekonomike ishte 0.3 përqind (0.2 përqind në TM3 2014). Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2015, aktiviteti ekonomik në eurozonë vlerësohet të jetë ngadalësuar, kryesisht si pasojë e rënies së kërkesës së jashtme, gjë që u reflektua në rënie të eksporteve, si dhe aktivitetit më të dobët industrial.

Ngadalësimi ekonomik me të cilin u përball ekonomia e Kinës dhe ekonomitë tjera në zhvillim ndikuan në rënien e kërkesës për eksportet e eurozonës, veçanërisht të Gjermanisë dhe Italisë. Rritja modeste e ekonomive të eurozonës u mbështet kryesisht nga kërkesa e brendshme, përderisa çmimet e ulëta të naftës dhe niveli i përgjithshëm i inflacionit kanë kontribuar pozitivisht në rritjen e të ardhurave të disponueshme të ekonomisë. Me rritje më të ngadalshme ekonomike kundrejt tremujorit paraprak u karakterizua Gjermania, Austria, Italia dhe Spanja, përderisa Greqia shënoi rënie ekonomike tremujore në të njëjtën periudhë. Përjashtim bëri vetëm ekonomia e Francës, që u karakterizua me një rritje të aktivitetit ekonomik kundrejt tremujorit paraprak, mbështetur kryesisht nga rritja e shpenzimeve të konsumatorit. Rikuperimi i brishtë i ekonomive të eurozonës, si dhe rikthimi i inflacionit në terren negativ ka rritur mundësinë e zgjerimit dhe shtimit të instrumenteve të lehtësismit sasior nga ana e BQE-

së. Ecuritë në çmimet e naftës dhe lëndëve të para, si dhe rikuperimi ende i ngathët përgjithësisht në eurozonë, sugjeron për presione të ulëta inflacioniste për pjesën e mbetur të vitit.

Sipas BQE-së, eurozona u karakterizua me normë inflacioni prej 0.1 përqind në tremujorin e tretë të vitit 2015, megjithëse në shtator 2015, shënoi një normë deflacioni prej 0.1. Shkalla e inflacionit në eurozonë pritet të mbetet tejte e ulët në muajt në vijim, përderisa në fund të vitit 2015 pritet një ngritje graduale e shkallës së inflacionit. Për vitin 2015 në tërësi, FMN ka parashikuar një normë të inflacionit prej 0.2 përqind. Rritja graduale e shkallës së inflacionit pritet të nxitet kryesisht nga ndikimi i politikave lehtësuese monetare në kërkesën e përgjithshme në eurozonë, ndikimi i normës së ulët të këmbimit të euros, si dhe pritjet për rritje graduale të çmimeve të naftës.

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së



BQE vazhdoi të mbaj të pandryshuar normën bazë të rifinancimit edhe në qershor 2015. Megjithatë, lansimi i programit të gjerë stimulues që nga marsi i këtij viti ka ndikuar në rënien e normave 1 mujore

dhe 12 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. Në shtator 2015, normat 1 mujore të Euribor kanë rënë në mesatarisht -0.09 përqind nga -0.05 përqind në qershor 2015. Në anën tjetër, normat mesatare për periudhën 12-mujore kanë shënuar rënie në mesatarisht 0.16 përqind në shtator 2015, nga mesatarja prej 0.17 përqind në qershor 2014.

Performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor në nëntë muajt e parë të vitit 2015 vlerësohet të ketë shënuar përmirësim. Përforcimi i kërkesës së jashtme si rezultat i rikuperimit gradual të eurozonës, forcimi i konsumit privat dhe rritja e kreditimit kanë mbështetur aktivitetin ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor në masa të ndryshme. Sipas parashikimeve të FMN-së, vendet në Ballkanin Perëndimor presin të shënojnë një rritje mesatare të PBB-së prej 2.2 përqind në vitin 2015. Mali i Zi, Maqedonia dhe Kosova pritet të karakterizohen me një normë më të lartë të rritjes ekonomike prej 3.2 përqind në vitin 2015, përderisa Serbia pritet të jetë që përfundimisht të tejkaloj recesionin që e karakterizoi në vitin 2014 dhe të shënojë një rritje reale të ekonomisë prej 0.5 përqind.

Ngjashëm me eurozonën, vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2015 u karakterizuan me presione të dobëta inflacioniste, ndikuar kryesisht nga kërkesa ende e dobët e brendshme në disa nga vendet dhe çmimet e ulëta të mallrave të tregjet ndërkombëtare. Megjithatë, FMN parashikon një normë mesatare të inflacionit prej 0.8 përqind në vendet e regjionit për vitin 2015 (0.2 përqind në eurozonë në vitin 2015). Shqipëria pritet të karakterizohet me shkallën më të lartë të inflacionit


prej 2.2 përqind, pasuar nga Mali i Zi dhe Serbia me 1.7 përqind dhe 1.6 përqind. Sipas FMN-së, Kosova dhe Kroacia priten të karakterizohen me deflacion prej 0.5 përqind dhe 0.4 përqind.

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Bazuar në indikatorët makroekonomik, vlerësohet se ekonomia e Kosovës deri në shtator 2015 është karakterizuar me rritje të aktivitetit ekonomik. Sipas të dhënave të ASK-së vlerësohet se ekonomia e Kosovës shënoi rritje prej 0.2 përqind në TM1 2015 ndërsa në TM2 2015 është shënuar rritje dukshëm më e lartë (3.4 përqind). Për tërë vitin 2015, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të karakterizohet me përshpejtim të rritjes ekonomike, duke shënuar një normë reale të rritjes së PBB-së prej 3.5 përqind, e cila pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme (figura 2).

Figura 2. Rritja reale e PBB-së, në përqindje




*Të dhënat për vitin 2015 paraqesin parashikimin e BQK-së
Burimi: ASK (2015)

Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet që edhe gjatë vitit 2015 të ketë kontributin kryesor në rritjen ekonomike. Në anën tjetër, investimet të cilat në vitin e kaluar vlerësohet

të kenë shënuar rënie, gjatë këtij viti pritet të shënojnë rritje. Rritja e kërkesës së brendshme pritet të ndikojë në rritje të importit dhe, rrjedhimisht, në rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Ndërsa, llogaria financiare e bilancit të pagesave pritet të përmirësohet, kryesisht si rezultat i parashikimeve për rritje të investimeve të huaja direkte.

Niveli i çmimeve në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), deri në shtator 2015 është karakterizuar me deflacion prej 0.6 përqind krahasuar me inflacionin prej 0.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 3).

Figura 3. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2015)

Në rënien e çmimeve kontribuuan kryesisht shërbimet arsimore të cilat shënuan rënie për 28.0 përqind, transporti që shënoi rënie të çmimeve për 7.6 përqind dhe shërbimet e restoranteve dhe hoteleve të cilat shënuan rënie për 3.2 përqind. Rënia e çmimit të shërbimeve arsimore i atribuohet vendimit të qeverisë për zbritjen e pagesës për 50 përqind për studentët e universiteteve publike, vendim i cili është aplikuar me fillimin e vitit akademik në tetor të vitit të kaluar, ndërsa rënia e çmimeve të shërbimeve të transportit i

atribuohet rënies së çmimit të derivateve të naftës. Në anën tjetër, çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit u rritën për 5.1 përqind, si dhe çmimet e strehimit, ujit, rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse shënuan rritje për 3.6 përqind. Me rritje prej 0.6 përqind u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike të cilat përfaqësojnë rreth 40.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar (figura 4).


Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2015)

Lëvizja e çmimeve në Kosovë është e ngjashme me lëvizjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importet. Kjo tregohet edhe nga sjellja e ngjashme e indeksit të çmimeve të importit me CPI-në (figura 5).

Figura 5. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2015)


Çmimet e importit¹ deri në qershor të vitit 2015 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak shënuan rënie mesatare prej 0.4 përqind. Çmimet e produkteve minerale (kryesisht naftës dhe derivateve të saj) të cilat janë kategoria kryesore e indeksit të çmimeve të importit shënuan rënien më të lartë, pasuar nga çmimet e plastikës, metalet bazë si dhe mjetet e transportit. Në anën tjetër, çmimet e produkteve bimore dhe pajisjet e makinerisë shënuan rritjen më të lartë të çmimeve, pasuar nga shtazët e gjalla dhe produktet e tyre.

Indeksi i çmimeve të prodhimit deri në qershor 2015 shënoi rritje mesatare vjetore prej 3.9 përqind. Rritja e çmimeve të prodhimit ishte më e theksuar te çmimet e prodhimit të produkteve kimike, pastaj rritjes së çmimeve të prodhimit të drurit dhe produkteve të drurit, energjisë elektrike, gazit, avullit dhe furnizimit me ajër të kondicionuar. Në anën tjetër, rënia e çmimeve të prodhimit më së shumti ishte evidente te prodhimi i produkteve metalike, pasuar nga rënia e çmimeve të prodhimit të letrës dhe produkteve të letrës, prodhimi i lëkurës dhe produkteve nga lëkura.

Sa i përket regjistrimit të ndërmarrjeve, është shënuar rritje e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe rritje e numrit të ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara deri në shtator 2015 ishte 7,353 që është për 124 ndërmarrje më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa u mbyllën 1,235 ndërmarrje apo 11 ndërmarrje më shumë se sa në

periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 6).

Figura 6. Regjistrimi i bizneseve, jo kumulative




Burimi: ASK (2015)

Edhe gjatë kësaj pjese të vitit 2015 dominuan ndërmarrjet e regjistruara në tregti me 2,157 ndërmarrje të reja, prodhimtari me 776 ndërmarrje, hoteleri me 772 ndërmarrje dhe bujqësi me 675 ndërmarrje (figura 7). Kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, tek sektori i bujqësisë është shënuar rritja më e lartë e ndërmarrjeve të regjistruara prej 169 ndërmarrje më shumë, pasuar nga aktivitetet financiare të cilat kanë shënuar rritje prej 39 ndërmarrjeve si dhe sektori i prodhimit i cili ka shënuar rritje të ndërmarrjeve të regjistruara prej 14 sosh më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërsa, në sektorin e ndërtimtarisë janë regjistruara 47 ndërmarrje më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në hoteleri 40 ndërmarrje më pak dhe në tregtia 8 ndërmarrje më pak.

¹ Bazuar në kalendarin e publikimeve të ASK-së indeksi i çmimeve të importit dhe prodhimit për tremujorin e tretë të vitit 2015 do të publikohet me 16 dhe 18 dhjetor 2015.

Figura 7. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2015)

Sektori Fiskal

Të hyrat primare buxhetore² deri në shtator 2015 arritën vlerën bruto prej 1.07 miliardë euro. Nëse përjashtohen 27.1 milionë euro kthime të TVSH-së dhe tatimeve tjera nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës, atëherë të hyrat primare buxhetore shënojnë vlerën neto prej 1.04 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.9 përqind. Në të njëjtën periudhë, shpenzimet primare buxhetore³ arritën vlerën prej 1.03 miliardë euro që paraqet rritje prej 6.0 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc të përgjithshëm pozitiv prej rreth 790 mijë euro krahasuar me bilancin e përgjithshëm negative prej 14.84 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore, vërehet rritje e të hyrave të mbledhura nga tatimet vendore të cilat arritën vlerën bruto prej 246.2 milionë euro.

² Në kuadër të të hyrave primare nuk janë përfshirë të hyrat nga huamarrjet, pranimet nga grantet e përgjithshme të donatorëve dhe pranimet e depozitave.

³ Në kuadër të shpenzimeve primare nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe kthimet nga fondet e depozitave.

Nëse përjashtohen kthimet e administratës tatimore prej 23.1 milionë euro, atëherë të hyrat neto nga tatimet vendore shënuan rritje prej 11.9 përqind dhe arritën vlerën prej 223.1 milionë euro. Të hyrat e mbledhura nga tatimet kufitare arritën vlerën neto prej 676.5 milionë euro që janë për 7.0 përqind më të larta se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2014. Të hyrat jo-tatimore arritën vlerën prej 125.8 milionë euro apo 7.5 përqind më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Sa i përket shpenzimeve, pagat e mëditjet dhe subvencionet e transferet shënuan rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa shpenzimet kapitale dhe mallrat e shërbimet shënuan rënie. Investimet kapitale, të cilat deri në shtator të vitit 2015 përfaqësuan rreth 20.5 përqind të gjithsej shpenzimeve, u zvogëluan në 212.8 milionë euro nga 222.2 milionë euro që paraqet rënie prej 4.2 përqind. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime kanë shënuar rënie për 5.6 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 114.1 milionë euro. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje kanë shënuar rritje prej 9.0 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 389.9 milionë euro. Subvencionet dhe transferet po ashtu kanë shënuar rritje për 16.3 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 292.4 milionë euro. Rritja e këtyre dy kategorive në krahasim me vitin e kaluar i atribuohet faktit se vendimi qeverisë për rritjen e pagave dhe pensioneve i vitit të kaluar ka filluar të zbatohet pas tremujorit të parë të vitit 2014.

Borxhi publik, deri në shtator 2015, ka arritur në 719.5 milionë euro nga 550.9 milionë euro sa ishte në shtator 2014, ndërsa si përqindje e PBB-së ka arritur në rreth 12.5 përqind nga 10.2 përqind sa ishte në

vitin paraprak. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet kryesisht rritjes së borxhit të brendshëm prej 51.0 përqind (i cili ka arritur në 352.3 milionë euro), ndërkohë që edhe borxhi i jashtëm ka shënuar rritje të konsiderueshme prej 15.6 përqind duke arritur në 367.2 milionë euro.


Sektori i Jashtëm

Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 324.0 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 276.3 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse kryesisht i atribuohet rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së shërbimeve dhe të ardhurave parësore dhe dytësore. Deri në shtator të vitit 2015, deficitin në tregtinë e mallrave u karakterizua me një rritje vjetore prej 0.2 përqind nga periudha e njëjtë e vitit paraprak, përderisa llogaria e shërbimeve dhe e ardhurave parësore dhe dytësore u karakterizuan me zvogëlim të bilancit pozitiv për 2.8, 33.7 përkatësisht 0.4 përqind.

Gjithsej eksportet në shtator të vitit 2015 arritën vlerën 250.9 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 5.6 përqind (figura 8)⁴. Rritja e eksporteve gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rritjes së eksporteve të plastikës dhe gomës, eksporteve të produkteve ushqimore si dhe rritjes së eksporteve të produkteve minerale. Si pasojë e rënies së çmimeve në tregjet ndërkombëtare të metaleve kryesore që Kosova eksporton, eksportet e metaleve bazë shënuan rënie në shtator 2015.

Vlera e gjithsej importeve në Kosovë, deri në shtator 2015, arriti në 1.9 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.9 përqind. Në kuadër të gjithsej importeve, me rritje u karakterizuan kategoritë e produkteve ushqimore, importet e metaleve bazë, importet e plastikës dhe gomës dhe importet e mjeteve të transportit.

Figura 8. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro



Burimi: ASK (2015)

Si rezultat i rritjes më të shpejtë të vlerës së eksporteve në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2015, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte u rrit në 13.1 përqind, nga 12.7 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.


Tregtia në shërbime u karakterizua me zvogëlim të bilancit pozitiv në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Bilanci i shërbimeve shënoi vlerën prej 268.8 milionë euro në këtë periudhë (276.4 milionë euro deri në shtator 2014). Në kuadër të tregtisë në shërbime, eksporti i shërbimeve në nëntë muajt e parë të vitit 2015 shënoi një rritje vjetore prej 5.7 përqind, duke arritur vlerën prej 609.4 milion euro. Në të njëjtën periudhë, vlera e gjithsej shërbimeve të importuara shënoi një rritje prej 13.4 përqind dhe arriti vlerën prej 340.6 milion euro. Në kuadër të shërbimeve të

⁴ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është ASK, që është dhe prodhues zyrtar i këtyre statistikave.

eksportuara, shërbimet e udhëtimit u karakterizuan me rritje vjetore prej 13.0 përqind në nëntë muajt e parë të vitit 2015, përderisa kategoria e shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit si dhe kategoria e shërbimeve të biznesit u karakterizuan me rënie prej 23.8 përkatësisht 18.0 përqind. Sa i përket shërbimeve të importuara, me rritje në nëntë muajt e parë të vitit 2015 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak, u karakterizuan shërbimet e transportit, udhëtimit dhe shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit (72.5, 10.0 përkatësisht 34.0 përqind).

Kategoria më e madhe në kuadër të të hyrave të llogarisë së të ardhurave parësore mbeten të hyrat nga kompensimi i punonjësve, gjegjësisht të hyrat nga të ardhurat e punonjësve kosovarë jashtë vendit.⁵ Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, të hyrat nga kompensimi i punonjësve shënuan rritje vjetore prej 2.4 përqind, duke arritur në 165.6 milionë euro.

Figura 9. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)


Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të

⁵ Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të paguara për punëtorët jorezident në vend, apo të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

llogarisë së të ardhurave dytësore, deri në shtator 2015 arriti vlerën 566.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.0 përqind (figura 9). Remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 36.3 përkatësisht 22.1 përqind të gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave në vitin 2015 është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 7.2 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.

Bilanci i Investimeve të Huaja Direkte (IHD) deri në shtator 2015 arriti në 250.1 milionë euro, që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me vlerën prej 104.8 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me rritje të vlerës u karakterizuan të dy format e IHD-ve, përfshirë kapitalin dhe fondin e investimeve në aksione dhe investimet në instrumentet e borxhit (figura 10). Sektorët që përfituan më shumë nga rritja e IHD-ve ishin sektori i patundshmërive, qiradhënies dhe aktiviteteve tjera biznesore, sektori i shërbimeve financiare, sektori i ndërtimit, transporti dhe komunikimi, etj.

Figura 10. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Sistemi Financiar

Në shtator 2015, vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 4.77 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 7.1 përqind (figura 11). Kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit të sistemit e kishin sektori bankar dhe sektori pensional.

Figura 11. Asetet e sistemit financiar, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Sektori Bankar

Asetet

Sektori bankar në shtator 2015 zgjeroi vlerën e asetëve në 3.32 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 5.5 përqind (7.3 përqind në shtator 2014) (figura 12). Kontributin më të lartë në rritjen e asetëve të sektorit dha zgjerimi i portfolios së kredive i cili vazhdon të jetë kategoria dominuese në strukturën e asetëve të sektorit bankar. Sidoqoftë norma më e ulët e rritjes reflekton ecurinë e depozitave si burim kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit bankar.

Figura 12. Asetet e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Letrat me vlerë, si kategoria e dytë për nga madhësia në kuadër të aktivitetit të sektorit bankar, shënoi rritje vjetore prej 15.5 përqind duke arritur në 473.4 milionë euro në shtator 2015. Sidoqoftë, ritmi i rritjes ishte i ngadalësuar krahasuar me rritjen prej 48.6 përqind të shënuar në shtator 2014. Ngadalësimi ishte kryesisht si pasojë e rënies vjetore prej 2.8 përqind (krahasuar me rritjen prej 45.3 përqind në shtator 2014) të investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja. Normat shumë të ulëta të kthimit (disa dhe negative) në letra me vlerë të qeverive të huaja krahas normave më atraktive të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës inkurajuan zhvendosjen e investimeve drejt këtyre të fundit të cilat në shtator 2015 shënuan rritje vjetore prej 42.5 përqind, duke zgjeruar kështu pjesëmarrjen në 49.7 përqind të gjithsej portfolios së investimeve në letra me vlerë (40.2 përqind ishte pjesëmarrja në shtator 2014).

Pesha e kategorisë së parasë së gatshme dhe bilancit me BQK mbeti e ngjashme me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, përkundër faktit që gjatë kësaj periudhe kjo kategori u karakterizua me rritje të


konsiderueshme prej 4.5 përqind krahasuar me rënien prej 5.8 përqind në shtator 2014. Rritja ishte si rezultat i rritjes së rezervave të përgjithshme të bankave komerciale të mbajtura në BQK.

Kategoria e bilancit me bankat komerciale, që përfshinë depozitat dhe linjat kreditore në bankat jashtë vendit përfshirë, ishte e vetmja kategori e cila e ngushtoi pjesëmarrjen në gjithsej asetet e sektorit. Zvogëlimi i peshës në strukturë të aseteve kryesisht reflekton ecurinë negative të kësaj kategorie gjatë kësaj periudhe, ku bilanci me bankat tjera në shtator 2015 shënoi rënie vjetore prej 13.3 përqind (në shtator 2014 kishte rritje prej 17.4 përqind). Rënia ishte si rrjedhojë e rënies së theksuar të depozitave të transferueshme dhe të atyre me afat në valutën euro të mbajtura në bankat jashtë vendit, që konsiderohen të jenë ndikuar nga normat negative të depozitave në bankat e eurozonës të përcaktuara me politikën e BQE.

Kreditë

Kreditë e sektorit bankar vazhduan të karakterizohen me përshpejtim të rritjes, ku në shtator 2015 vlera e gjithsej kredive arriti në 1.99 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 7.5 përqind (3.2 përqind në shtator 2014) (figura 13). Rritja e i atribuohet lehtësimit të standardeve dhe kushteve të kreditimit të ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare nga ana e bankave, e realizuar përmes uljes së normave të interesit, zgjerimit të shumës së kredisë afatit të maturimit në kreditë e ofruara. Poashtu, bankat kanë raportuar të ketë pasur rritje të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet si dhe rritje të kërkesës për kredi konsumuese dhe hipotekare nga ekonomitë familjare.


Figura 13. Ecuria e kredive dhe depozitave



Burimi: BQK (2015)

Në kuadër të gjithsej kredive, rritjen më të lartë vjetore kishin kreditë për ekonomi familjare të cilat shënuan rritje prej 9.0 përqind. Megjithatë kontributin kryesor në rimëkëmbjen e gjithsej kreditimit të sektorit e kanë dhënë kreditë për ndërmarrjet, të cilat kanë peshën kryesore në kuadër të gjithsej kredive dhe shënuan rritje vjetore prej 7.2 përqind (1.6 përqind në shtator 2014). Kreditë për ndërmarrjet përbëjnë 66.3 përqind të gjithsej kredive të sektorit bankar (figura 14).

Figura 14. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare




Burimi: BQK (2015)

Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike mbetet e kryesuar nga

kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë (me pjesëmarrje prej 52.4 përqind), pasuar nga ato për prodhimtari (me 13.0 përqind) dhe ndërtimtari (me 7.4 përqind). Sektorin e bujqësisë vazhdon të ketë çasje më të ulët në financimin bankar me pjesëmarrje prej 4.1 përqind, megjithëse gjatë kësaj periudhe është karakterizuar me rritje (figura 15).

Figura 15. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Sa i përket tendencave të fundit të kreditimit të sektorëve ekonomik, deri në shtator 2015, kreditimi i të gjithë sektorëve shënoi rritje të përsheptuar, duke përjashtuar sektorin e ndërtimit të cili vazhdon të karakterizohet me rënie të kreditimit që nga viti 2013.

Më konkretisht, rritjen më të theksuar e regjistroi kreditimi për sektorin e shërbimeve financiare me 67.1 përqind rritje (rënie 21.5 përqind në shtator 2014). Rritja kryesisht i atribuohet rritjes së regjistrimit të ndërmarrjeve të reja me aktivitet financiar dhe sigurime, ku periudha deri në shtator 2015 reflekton numrin më të madh të regjistrimeve në këtë sektor në krahasim me të gjitha periudhat e viteve paraprake. Specifikisht, deri në shtator 2015,

numri i ndërmarrjeve të reja ishte 70 krahasuar me 31 deri në shtator 2014.


Me rritje të përsheptuar u karakterizua edhe kreditimi i sektorit të bujqësisë i cili deri në shtator 2015 shënoi rritje vjetore prej 10.1 përqind, krahasuar me rënie prej 11.8 përqind në shtator 2014. Përmirësimi i theksuar i kreditimit të sektorit mund të jetë ndikuar nga dyfishimi i buxhetit të qeverisë për vitin 2015 për programin e subvencioneve dhe granteve në këtë sektor, gjë që u reflektua edhe në rritjen e numrit të bizneseve të reja të regjistruara. Deri në shtator 2015 janë raportuar rreth 33 përqind më shumë biznese të reja në sektorin e bujqësisë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Njëkohësisht edhe normat e interesit për bujqësi të ofruara nga bankat në shtator 2015 shënuan rënie prej 1.9 pikë përqindje.

Kreditimi i sektorit të tregtisë, gjithashtu shënoi rritje të përsheptuar prej 7.0 përqind në shtator 2015 (nga 3.2 përqind sa ishte në shtator 2014). Përsheptimi i rritjes, mes tjerash, reflekton rritjen e aktivitetit tregtar të Kosovës me vendet tjera në eksportimin dhe importimin e mallrave, përkundër rënies së numrit të bizneseve të regjistruara deri në shtator 2015 në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Sektorin tjetër i cili shënoi rritje të përsheptuar ishte ai i industrisë së prodhimit, i cili deri në shtator 2015 u karakterizua me rritje vjetore prej 17.4 përqind (13.5 përqind në shtator 2014). Rritja mund t'i atribuohet deri në një masë rritjes së ndërmarrjeve të reja me aktivitet prodhues të cilat mund të kenë rritur kërkesën për financim. Deri në shtator 2015,

numri i ndërmarrjeve të reja është 239 krahasuar me shtator 2014, kur numri i ndërmarrjeve të reja ishte 196 (figura 16).

Figura 16. Ndryshimi vjetor i kredive sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2015)

Në anën tjetër, përkundër rënies së normave të interesit dhe lehtësimit të standardeve të kreditimit nga ana e bankave, kreditimi i sektorit të ndërtimit vazhdon të jetë në rënie. Në shtator 2015, kreditë për sektorin e ndërtimit regjistruan rënie vjetore prej 11.1 përqind (rënie prej 11.0 përqind në shtator 2014).

Sipas afatit të maturimit, struktura e gjithsej kredive vazhdon të dominohet nga kreditë afatmesme, gjegjësisht kreditë me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’ (figura 17). Megjithatë, krahasuar me periudhat e kaluara, vërehet një tendencë e zhvendosjes drejt kreditimit afatgjatë. Në shtator 2015, kreditë afatshkurtra ‘deri në 1 vit’ shënuan rënie të pjesëmarrjes në strukturë krahas rritjes së ndjekur gjatë tri viteve të kaluara. Ndërsa, kategoria e kredive afatgjata ‘mbi 5 vite’ vazhdoi të rritet me ritëm më të shpejtë. Rritja e theksuar e peshës së kreditimit afatgjatë mund të reflektojë efektin e rritjes së kreditimit afatgjatë për sektorin e industrisë si dhe

rritjen e kreditimit hipotekar në kuadër të kredive për ekonomi familjare.

Figura 17. Kreditë sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Aktiviteti kreditues i sektorit bankar në shtator 2015 u karakterizua me ritëm të përshpejtuar të rritjes, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja ishte më e theksuar te sektori i prodhimit dhe sektori i bujqësisë, kreditimi i të cilëve shënoi rritje me ritëm të përshpejtuar krahasuar me vitin e kaluar.

Detyrimet

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar vazhdon të dominohet nga depozitat, që përbejnë rreth 80 përqind të gjithsej detyrimeve, duke përfaqësuar kështu burimin kryesor të financimit të aktivitetit të sektorit bankar. Mbështetja e lartë në depozitat e mbledhura brenda vendit, dhe veçanërisht në depozita të ekonomive familjare të cilat konsiderohen burim më i qëndrueshëm i financimit, eviton ekspozimin e sektorit ndaj lëvizjeve në tregjet e jashtme.

Mjetet vetanake, si kategoria e dytë për nga pjesëmarrja në gjithsej detyrimet e sektorit, në shtator 2015 shënuan rritje vjetore prej 15.5 përqind


(13.8 përqind në shtator 2014). Kjo rritje ishte si rezultat i rritjes së lartë të profitit të realizuar nga sektori bankar gjatë vitit të kaluar dhe që ka vazhduar edhe gjatë nëntmujorit të vitit 2015.

Kategoria e cila shënoi rritje të theksuar në kuadër të gjithsej detyrimeve ishte bilanci nga bankat tjera, që në shtator 2015 u rrit në 46.8 milionë euro nga 22.2 milionë euro sa ishte në shtator 2014. Rritja rezultoi nga nevojat e bankave për huazim të mjeteve afatshkurtëra nga bankat jashtë vendit, përfshirë dhe bankat amë. Në anën tjetër, kategoria e huazimeve tjera (përfshirë çertifikatat e depozitave) shënoi rënie vjetore prej 21.0 përqind në shtator 2015.

Depozitat

Vlera e gjithsej depozitave në sektorin bankar të Kosovës arriti në 2.66 miliardë euro në shtator 2015, që paraqet rritje vjetore rreth 5.5 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 7.4 përqind në shtator 2014 (figura 18). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, vërhet ngadalësim në normën e rritjes së depozitave, gjë që mund të jetë pasojë e normave të ulëta të interesit në depozita, por edhe efektit të migrimit në fillim të vitit 2015.


Figura 18. Depozitat, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Struktura e depozitave dominohet nga depozitat e ekonomive familjare, të cilat përbëjnë 72.8 përqind të gjithsej depozitave. Kategoria e dytë për nga pesha në strukturë është ajo e depozitave të ndërmarrjeve me pjesëmarrje prej 20.9 përqind të gjithsej depozitave (figura 19).

Figura 19. Struktura e depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2015)


Sa i përket ecurisë së depozitave, ritmi i rritjes së gjithsej depozitave diktohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare si kategoria dominuese, të cilat në shtator 2015 regjistruan normë vjetore të rritjes prej 5.5 përqind (7.5 përqind në shtator 2014).

Depozitat e ndërmarrjeve në shtator 2015 kishin rritje vjetore prej 2.9 përqind (nga rritja prej 8.2 përqind në shtator 2014) ndërsa depozitat tjera (depozitat e jo-rezidentëve, organizatave jo-qeveritare, qeveritë qendrore dhe lokale etj.) shënuan rritje vjetore prej 17.2 përqind në shtator 2015 (3.0 përqind në shtator 2014).

Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit ka pësuar ndryshime, ku vërehet një rënie e pjesëmarrjes së depozitave të afatizuara, që kryesisht mund të jetë pasojë e rënies së normave të interesit në depozita. Në shtator 2015, depozitat e afatizuara

shënuan rënie të pjesëmarrjes në 25.2 përqind të gjithsej depozitave (nga 36.1 përqind në shtator 2014), derisa depozitat e transferueshme kanë rritur pjesëmarrjen në 54.1 përqind (43.7 përqind në shtator 2014) kurse depozitat e kursimit nuk kanë shënuar lëvizje të theksuar dhe përbëjnë 20.7 përqind të gjithsej depozitave (figura 20).


Figura 20. Struktura depozitave sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Edhe pse depozitat e afatizuara janë karakterizuar me rënie, në kuadër të strukturës së tyre vërehet një zhvendosje e ndjeshme drejt afateve më të gjata të maturimit. Depozitat me afat të gjatë maturimi ‘mbi 2 vite’ dhe ato afatmesme ‘mbi 1 deri në 2 vite’ kanë rritur pjesëmarrjen në strukturë, ndërsa depozitat afatshkurta ‘deri 1 vit’ kanë zvogëluar pjesëmarrjen në strukturën e gjithsej depozitave të afatizuara (figura 21). Këto lëvizje janë konform normave të interesit, të cilat janë më të larta për depozitat me maturitet më të gjatë.

Figura 21. Depozitat e afatizuara, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Depozitat vazhduan të shënojnë rritje, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak. Gjatë kësaj periudhe struktura e depozitave ka pësuar ndryshime, ku depozitat e afatizuara u karakterizuan me ngushtim të pjesëmarrjes, përdërisa depozitat e transferueshme regjistruan zgjerim të pjesëmarrjes në strukturën e gjithsej depozitave.

Normat e Interesit⁶


Normat e interesit në sektorin bankar vazhduan të karakterizohen me trende rënëse. Për dallim nga periudha paraprake ku rënia vjetore ishte më e theksuar në normën në depozita, në shtator 2015, rënia vjetore ishte më e shprehur në normën e interesit në kredi.

Norma mesatare e interesit në kredi në shtator 2015 u zvogëluar në 7.9 përqind nga 10.7 përqind sa ishte në shtator 2014. Në depozita, norma mesatare e interesit u zvogëluar në 0.9 përqind nga 1.1 përqind sa ishte në shtator 2014. Prania e mjaftueshme e mjeteve likuide në sektorin bankar është faktori kryesor që po ndikon në ofrimin e normave të ulëta të interesit në depozita. Në shtator 2015, dallimi në mes të normës së interesit

⁶ Nga muaji shtator 2015 ka ndryshuar metodologjia e raportimit të normave të interesit, andaj mund të ketë dallime në vlerat e normave të interesit si në kredi dhe depozita të raportuara në publikimet e mëparshme.

në kredi dhe depozita u zvogëlua në 7.0 përqind nga 9.7 përqind sa ishte në shtator 2014 (figura 22).

Figura 22. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK (2015)

Rënia e normave të interesit në kredi ishte më e shprehur në kreditë për ndërmarrjet krahasuar me kreditë ndaj ekonomive familjare. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në shtator 2015 u zvogëlua në 7.5 përqind nga 10.8 përqind sa ishte në shtator 2014. Në kuadër të ndërmarrjeve, rënia më e theksuar u shënuar në kreditë jo-investuese të cilat në shtator 2015 zbritën në 8.0 përqind nga 11.2 përqind në shtator 2014., Kreditë investuese vazhdojnë të kenë normat më të ulëta të interesit përkundër rënies më të lehtë në 7.4 përqind nga 10.7 përqind në shtator 2014 (figura 23).

Sipas afatit të maturimit, kreditë investuese me afat maturimi ‘mbi 5 vite deri 10 vite’ kishin normën më të ulët të interesit (7.1 përqind), përderisa ato jo investuese me afat maturimi ‘mbi 5 vite deri 10 vite’ kishin normën më të lartë të interesit (10.4 përqind).


Figura 23. Norma mesatare e interesit në kreditë e ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2015)

Ndërsa, sipas veprimtarisë ekonomike, me rënie të normave të interesit në kredi u karakterizuan të gjithë sektorët ekonomik, por rënia ishte më e theksuar në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve dhe të industrisë. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve u zvogëlua në 7.4 përqind në shtator 2015 (11.2 përqind në shtator 2014), ndërsa për sektorin e industrisë u zvogëlua në 7.5 përqind (10.3 përqind në shtator 2014). Siç mund të shihet edhe në figurën 24, trendi rënës i normave të interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë ishte më i theksuar krahasuar me rënien e normave për veprimtaritë tjera ekonomike. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj këtij sektori u zvogëlua në 9.3 përqind në shtator 2014 nga 11.2 përqind sa ishte në shtator 2014. Megjithatë, pavarësisht trendit rënës, kreditë për bujqësi vazhdojnë të kenë normat më të larta të interesit krahasuar me sektorët tjerë.


Figura 24. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2015)

Në shtator 2015, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare u zvogëlua në 8.5 përqind, nga 10.6 përqind sa ishte në shtator 2014. Sipas qëllimit të përdorimit, normat e interesit në kreditë konsumuese shënuan rënien më të madhe në 8.8 përqind në shtator 2015 (10.9 përqind në shtator 2014), përderisa norma mesatare e interesit për kreditë hipotekare u zvogëlua në 7.0 përqind (9.1 përqind në shtator 2014) (figura 25).

Figura 25. Norma mesatare e interesit në kreditë e ekonomive familjare




Burimi: BQK (2015)

Në kuadër të kredive hipotekare, kreditë me maturim më afatgjatë kishin norma më të favorshme të interesit. Më konkretisht, kreditë hipotekare me afat maturimi ‘mbi 10 vite’ kishin normë mesatare të

interesit prej 6.2 përqind në shtator 2015 (8.5 përqind në shtator 2014).

Sa i përket normave të interesit në depozita, vërehet një ngadalësim i trendit të rënies së normës së interesit si në depozitat e ndërmarrjeve ashtu edhe në ato të ekonomive familjare krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë (figura 26). Normat e interesit në depozitat e ndërmarrjeve shënuan rënie në 0.6 përqind nga 1.4 përqind sa ishin në shtator 2014. Normat më të ulëta të interesit ishin të pranishme në depozitat me afat maturimi ‘mbi 1 muaj deri në 3 muaj’ (0.5 përqind), kurse, normat më të larta u hasën në depozitat me afat maturimi ‘deri në 1 muaj’ (0.8 përqind). Për depozitat e ekonomive familjare, normat e interesit u zvogëluan në 0.9 përqind nga 1.0 përqind sa ishin në shtator 2014. Normat më të ulëta të interesit në kuadër të ekonomive familjare ishin të pranishme në depozitat me afat maturimi ‘mbi 3 muaj deri në 6 muaj’ (0.4 përqind), përderisa ato më të lartat në depozitat me afat maturimi ‘mbi 2 vite’ (2.0 përqind).

Figura 26. Norma mesatare e interesit në depozita



Burimi: BQK (2015)

Performanca e sektorit bankar

Profiti i realizuar nga sektori bankar deri në shtator 2015 arriti vlerën 69.3 milionë euro, që është për 22.4 milionë euro më i lartë krahasuar me profitin e realizuar gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Përmirësimi i performancës financiare të sektorit bankar në dy vitet e fundit është rrjedhojë e zvogëlimit të theksuar të shpenzimeve, përderisa të hyrat e sektorit bankar vazhduan të shënojnë rënie të lehtë.

Të hyrat e sektorit bankar deri në shtator 2015 shënuan vlerën 179.2 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.3 përqind. Në kuadër të gjithsej të hyrave të hyrat nga interesi deri në shtator 2015 arritën vlerën 140.8 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 4.7 përqind. Kjo rënie i atribuohet zvogëlimit të të hyrave nga interesi në kredi kryesisht si rrjedhojë e rënies së normave të interesit. Të hyrat nga jo-interesi deri në shtator 2015 shënuan rritje vjetore prej 6.4 përqind kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave nga tarifat dhe komisionet. Rritja e të ardhurave nga tarifat dhe komisionet kryesisht i atribuohet shtrenjëtimit të shërbimeve të ofruara në degët bankare.

Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar deri në shtator 2015 arriti në 109.9 milionë euro, e cila është për 26.7 milionë euro më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Zvogëlimi i gjithsej shpenzimeve në masë të madhe ishte rezultat i reduktimit të shpenzimeve të interesit, që shënuan rënie vjetore prej 50.9 përqind. Kjo rënie ishte kryesisht rezultat i zvogëlimit të normës së interesit në depozita krahasuar me vitin e kaluar,


karakteristikë kjo e sektorit bankar në dy vitet e fundit.

Poashtu, kontribut në zvogëlimin e gjithsej shpenzimeve kishte edhe reduktimi i shpenzimeve të jo-interesit, të cilat shënuan rënie vjetore prej 60.4 përqind. Në kuadër të tyre, rënie drastike shënuan shpenzimet për provizionet në kredi të cilat u zvogëluan në 31.5 mijë euro nga 14.2 milionë të ndara deri në shtator të vitit 2014. Rënia e shpenzimeve për provizione është rezultat i zvogëlimit të vlerës së gjithsej kredive jo-performuese gjatë kësaj periudhe, duke ndikuar kështu që shumica e provizioneve të kërkuara për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë të jetë më e ulët.

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, që përfaqësojnë pjesën më të madhe të gjithsej shpenzimeve, shënuan rritje vjetore prej 4.0 përqind gjatë kësaj periudhe. Kjo rritje në masë të madhe i atribuohet shpenzimeve tjera nga jo interesi, ndërsa në një shkallë më të ulët i atribuohet edhe shpenzimeve të personelit.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave ka shënuar përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin e kaluar. Në shtator 2015, ky indikator u zvogëlua në 61.3 përqind, krahasuar me 74.4 përqind sa ishte deri në shtator 2014. Kjo ishte si rezultat i rënies së theksuar të shpenzimeve, pavarësisht rënies së lehtë në të hyrat e sektorit bankar (figura 27).


Figura 27. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2015)

Gjithashtu, profiti i realizuar deri në shtator 2015 ka ndikuar në përmirësimin e mëtutjeshëm të indikatorëve të profitabilitetit siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA arriti në 2.8 përqind, nga 2.0 përqind sa ishte në 2014, përderisa ROAE arriti në 26.3 përqind, nga 20.3 përqind sa ishte në 2014 (figura 28).⁷

Figura 28. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



*Për 2015 treguesit e profitabilitetit janë llogaritur duke u bazuar në performancën deri në shtator 2015

Burimi: BQK (2015)


Sektori bankar deri në shtator të vitit 2015 shënoi rritje të mëtutjeshme të profitabilitetit. Ngjashëm me vitin e kaluar, rritja e theksuar e profitit ishte kryesisht rezultat i reduktimit të konsiderueshëm të

shpenzimeve, përderisa të hyrat shënuan një rënie të lehtë.

Treguesit e shëndetit financiar

Kreditë joperformuese në sektorin bankar kanë shënuar rënie, përderisa është përmirësuar edhe më shumë mbulueshmëria e tyre me provizione. Në shtator 2015, pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kreditë u zvogëlua në 6.8 përqind nga 8.5 përqind sa ishte në shtator 2014 (figura 29). Rënia vjetore prej 14.0 përqind e vlerës së kredive jo performuese në njërin anë si dhe përshpejtimi i rritjes së gjithsej kreditimit kanë ndikuar në uljen e nivelit të NPL-ve (figura 30). Mbulueshmëria me provizione e kredive jo performuese në shtator 2015 u përmirësua në 116.5 përqind krahasuar me 112.2 përqind në shtator 2014.

Figura 29. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore




Burimi: BQK (2015)

Sektori bankar vazhdon të ketë nivel të kënaqshëm të kapitalizimit. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) arriti në 18.4 përqind në shtator 2015 nga 18.1 përqind sa ishte në shtator 2014. Për më tepër, kapitali i klasit të parë ndaj mjeteve të

⁷ ROAA dhe ROAE për vitin 2015 janë të aktualizuara me performancën e sektorit bankar deri në shtator 2015.

peshuara me rrezik shënoi përmirësim të theksuar në 16.0 përqind (14.8 përqind në shtator 2015).

Figura 30. Ndryshimi vjetor i gjithsej kredive dhe kredive joperformuese



Burimi: BQK (2015)


Përforcimi i kapitalizimit të sektorit bankar kryesisht i atribuohet rritjes së profitit të realizuar nga bankat. Sektori bankar vazhdon gjithashtu të ketë pozicion të kënaqshëm të likuiditetit. Në shtator 2015, raporti i kredive ndaj depozitave ishte 75.0 përqind, kurse raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 43.6 përqind në shtator 2015.⁸ Për më tepër, sektori bankar vazhdimisht po tejkalon minimumin e rezervave të obliguara të mbajtura, që është një tregues i nivelit të kënaqshëm të likuiditetit.

Sektori pensional

Vlera e aseteve të sektorit pensional në shtator 2015 arriti në 1.16 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 11.4 përqind (figura 31). Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) përfaqëson pjesën më të madhe të aseteve të sektorit (99.5 përqind), ndërsa pjesa e mbetur (0.5 përqind)

menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP).

Figura 31. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Asetet e FKPK-së gjatë nëntëmuajorit të vitit 2015 vazhduan të rriten kryesisht si rezultat i arkëtimeve të reja të kontributeve. Kurse, ndikim negativ në rritjen e mëtutjeshme të aseteve të FKPK-së kishte kthimi negativ nga investimet në sektorin e jashtëm. Në shtator 2015, vlera e gjithsej aseteve të FKPK-së arriti në 1.16 miliardë euro që përkon me rritje vjetore prej 11.5 përqind, dukshëm më e ulët se sa rritja prej 21.6 përqind në shtator 2014. Vlera e kontributeve të arkëtuara deri në shtator 2015 arriti në 101.4 milionë euro me rreth 498.8 mijë kontribues. Deri në shtator 2015, FKPK kishte kthim negativ në investime në vlerë prej 12.2 milionë euro krahasuar me kthimin pozitiv prej 46.4 milionë euro në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Lëvizjet e mëdha në tregjet financiare globale gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2015 si rezultat i zhvillimeve ekonomike dhe politike në disa vende të eurozonës dhe parashikimet për dobësim të ekonomisë kineze, që u reflektuan edhe në ekonominë e SHBA-ve, ndikuan në performancën negative të investimeve të jashtme të

⁸ Rregullorja përkatëse e BQK-së kërkon që raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra të mos jetë më i ulët se 25 përqind.


FKPK-së. Në ditën e fundit të muajit shtator 2015, çmimi i aksionit arriti në 1.273 euro (1.266 euro në shtator 2014).

Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve u karakterizua me rritje vjetore të aseteve dhe kthim pozitiv nga investimet. Në shtator 2015, vlera e gjithsej aseteve të FSKP-së arriti në 5.9 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 2.0 përqind, dukshëm më e ulët se sa rritja prej 11.0 përqind në shtator 2014. Vlera e kontributeve të arkëtuara deri në shtator 2015 arriti në 304.9 mijë euro me 3,990 kontribues. Kthimit bruto nga investimet deri në shtator 2015 arriti në 56.9 mijë euro (330.7 mijë euro deri në shtator 2014). Në ditën e fundit të shtatorit 2015, çmimi i aksionit të FSKP-së arriti në 143.61 euro (145.69 euro në shtator 2014).⁹

Sektori mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me zgjerim të aktivitetit, edhe pse me ritëm më të ngadalësuar, ku vlera e aseteve të sektorit në shtator 2015 arriti në 118.3 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 2.6 përqind (3.1 përqind në shtator 2014) (figura 32).


Figura 32. Asetet e sektorit mikrofinanciar, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar dominohet nga kreditë që përbëjnë 67.2 përqind të gjithsej aseteve të sektorit, të përcjellur nga kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha që janë lizingjet me pjesëmarrje prej 19.0 përqind në gjithsej asetet e sektorit mikrofinanciar (figura 33). Rrjedhimisht edhe zgjerimi i gjithsej aktivitetit të sektorit kryesisht reflekton ecurinë e kredive si kategoria kryesore e strukturës.

Figura 33. Asetet e sektorit mikrofinanciar, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Vlera e gjithsej kredive të sektorit në shtator 2015, arriti në 79.5 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 6.1 përqind (3.4 përqind në shtator 2014). Në rritjen e gjithsej kreditimit të sektorit, kontributin kryesor e kishin kreditë ndaj ndërmarrjeve, të cilat shënuan rritje vjetore prej 11.2 përqind në shtator 2015. Ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare, shënuan rritje vjetore prej 3.6 përqind. Rritja më e ulët e kredive për ekonomi familjare mund të jetë efekt i konkurrencës nga sektori bankar i cili ka lehtësuar standardet e ofertës kreditore përmes uljes së normave mesatare të interesit dhe zgjerimit të kreditimit gjatë kësaj periudhe.

⁹ Vlera bazë e aksionit të FSKP-së është 100 për dallim nga ajo e FKPK-së që është 1.


Struktura e kreditimit të sektorit sipas sektorëve ekonomik mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Kategoria kryesore mbeten kreditë e destinuar për shërbime tjera të cilat, në shtator 2015, përbëjnë 29.1 përqind të gjithëj kredive të sektorit. Kategoria e dytë për nga pesha mbeten kreditë e sektorit të bujqësisë me 25.9 përqind pjesëmarrje në strukturë, pasuar nga kreditë për ndërtimtari të cilat në shtator 2015 kishin pjesëmarrje prej 20.6 përqind. Kreditimi i sektorit të tregtisë përfaqëson 15.9 përqind të gjithëj kreditimit të sektorit, ndërsa sektori i industrisë mbetet sektori me qasjen më të ulët në financimin mikrofinanciar me vetëm 8.9 përqind pjesëmarrje.

Kreditimi mikrofinanciar sipas sektorëve ekonomik shënoi rritje në pothuajse të gjitha sektorët, përveç sektorit të tregtisë. Më konkretisht, kreditë për sektorin e industrisë regjistruan rritjen më të lartë vjetore prej 22.2 përqind në shtator 2015 (6.3 përqind në shtator 2014), pasuar nga kreditimi i sektorit të ndërtimtarisë i cili u karakterizua me rritje vjetore prej 18.0 përqind (7.8 përqind në shtator 2014). Rritja e theksuar e kreditimit mikrofinanciar për sektorin e ndërtimtarisë përkon me rënien e kreditimit bankar të kësaj veprimtarie.

Kreditimi për sektorin e shërbimeve tjera, që edhe dominon strukturën e gjithëj kredive, në shtator 2015 shënoi rritje vjetore prej 11.7 përqind krahasuar me rritjen prej 5.6 përqind në shtator 2014 (figura 34). Poashtu, kreditimi i sektorit të bujqësisë shënoi rritje të përshpejtuar vjetore prej 8.9 përqind krahas rritjes prej 0.6 përqind të regjistruar në shtator 2014. Rritja e qasjes së sektorit të bujqësisë si në kreditimin

mikrofinanciar ashtu edhe në atë bankar gjatë kësaj periudhe që mund të jetë si rezultat i rritjes së subvencioneve dhe granteve të qeverisë për këtë sektor për vitin 2015.

Figura 34. Kreditë e sektorit mikrofinanciar sipas sektorëve ekonomik, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Në anën tjetër, kreditimit i sektorit të tregtisë u karakterizuan me rënie të theksuar prej 1.6 përqind në shtator 2015 krahas rritjes vjetore prej 20.5 përqind të regjistruar në shtator 2014. Përputhja e rënies së kreditimit mikrofinanciar të sektorit të tregtisë me rritjen e kreditimit bankar për të njëjtin sugjeron konkurrencë më të fortë të sektorit bankar në financimin e kësaj veprimtarie në vend.

Struktura e kredive të sektorit sipas afatit të maturimit vazhdon të jetë e dominuar nga kreditë me maturim afat-mesëm. Në shtator 2015, kreditë me afat maturimi 'mbi 1 deri 5 vite' kishin një pjesëmarrje prej 84.9 përqind në gjithëj strukturën e kredive, pasuar nga ato me maturim 'deri 1 vit' me 14.8 përqind dhe 'mbi 5 vite' me 0.3 përqind të gjithëj strukturës së kredive (figura 35).

Figura 35. Kreditë e sektorit mikrofinanciar sipas maturitetit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar arriti në 22.4 milionë euro në shtator 2015, duke shënuar rënie vjetore prej 2.6 përqind. Ky rezultat u ndikua nga rënia e theksuar e lizingjeve për ndërmarrje që shënuan rënie vjetore prej 31.3 përqind. Ndërsa, lizingjet për ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje vjetore prej 54.6 përqind, e ndikuar kryesisht nga rritja e lizingut për kredi hipotekare.


Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar mbështetet kryesisht në huamarrjen nga sektori i jashtëm. Në shtator 2015, gjithsej huamarrjet e jashtme shënuan vlerën prej 62.0 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 2.1 përqind (rritje prej 2.6 përqind në shtator 2014). Rënia e huamarrjeve prej sektorit të jashtëm është reflektuar kryesisht në rënien e aktivitetit të lizingut gjatë kësaj periudhe.

Institucionet mikrofinanciare vazhdojnë të karakterizohen me nivel relativisht të ulët të kredive jo-performuese dhe nivel të kënaqshëm të provizioneve për mbulimin e kredive jo-performuese. Në shtator 2015, pjesëmarrja e kredive jo-performuese në gjithsej kreditë u zvogëlua në 5.1 përqind, në krahasim me normën prej 5.3 përqind sa

ishite në shtator 2014, ndikuar kryesisht nga ritmi më i lartë i rritjes së stokut të kredive krahas rritjes së vlerës së kredive jo-performuese. Gjithashtu, edhe mbulueshmëria me provizione u përmirësua në 119.7 përqind në shtator 2015, krahasuar me nivelin prej 111.4 përqind në shtator 2014.

Mesatarja e normës efektive të interesit në kreditë e lëshuara në shtator 2015 ishte 23.2 përqind (23.4 përqind në shtator 2014). Mesatarja e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare në shtator 2015 është rritur në 24.4 përqind nga 23.8 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kurse, mesatarja e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në shtator 2015 u zvogëlua në 21.1 përqind nga norma mesatare prej 21.3 përqind sa ishte në shtator 2014 (figura 36).

Figura 36. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2015)

Sektori i shërbimeve u kreditua me normë më të ulët mesatare të interesit që në shtator 2015 u zvogëlua në 21.3 përqind (nga 24.7 përqind sa ishte në shtator 2014). Ndërsa, normat mesatare të interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë dhe bujqësisë pësuan rritje. Normat e interesit për sektorin e

industrisë në shtator 2015 u rritën në 23.4 përqind nga 22.0 përqind sa ishin në shtator 2014, ndërsa ato për sektorin e bujqësisë arritën në 25.5 përqind (25.2 përqind në shtator 2014). Megjithatë, përkundër rritjes së normave mesatare të interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë dhe ndërtimtarisë, kreditimi për këta sektor regjistroj rritje.

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me performancë pozitive financiare, ku deri në shtator 2015 realizoi profit në vlerë prej 2.1 milionë euro krahasuar me 0.9 milionë euro profit të realizuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Operimi me fitim ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të të hyrave krahas rritjes së shpenzimeve.

Deri në shtator 2015, sektori realizoi të hyra në vlerë prej 15.6 milionë euro, që paraqet rritje vjetore të konsiderueshme prej 9.8 përqind krahasuar me rënie prej 1.7 përqind të shënuar deri në shtator 2014. Kjo ishte kryesisht rezultat i rritjes së të hyrave nga interesi, që shënuan rritje vjetore prej 8.6 përqind në shtator 2015. Në anën tjetër, shpenzimet arritën vlerën prej 13.5 milionë euro deri në shtator 2015 duke shënuar rritje të lehtë vjetore prej 1.2 përqind. Rritja ishte kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve nga interesi ndërsa shpenzimet për provizionet për humbjet nga kreditë shënuan rënie prej 5.7 përqind.


Rrjedhimisht profiti i realizuar deri në shtator 2015 ndikoj në përmirësimin e treguesve të profitabilitetit ku Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) u përmirësua në 2.4 përqind (0.6 përqind në vitin 2014), ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE) u

përmirësua në 8.9 përqind (2.4 përqind në vitin 2014).¹⁰

Sektori i sigurimeve

Gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve në shtator 2015 shënuan rritje vjetore prej 14.6 përqind, duke arritur vlerën 157.7 milionë euro (figura 37). Rritja poashtu u ndikua edhe si rezultat i fillimit të operimit në tregun vendor të dy kompanive të reja të cilat ofrojnë shërbime të jo-jetës. Sigurimet jo-jetë vazhdojnë të përfaqësojnë pjesën më të madhe të aseteve të sektorit (90.6 përqind), ndërsa pjesa e mbetur (9.4 përqind) menaxhohet nga sigurimet jetë. Ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, vlera e primeve të shkruara deri në shtator 2015 arriti në 62.6 milionë euro, nga të cilat 60.7 milionë euro përfaqësojnë sigurimin jo-jetë, ndërsa 2.0 milionë euro sigurimin jetë. Vlera totale e dëmeve të paguara deri në shtator 2015 arriti në 27.4 milionë euro, prej të cilave 16.7 milionë euro janë dëme të paguara në kuadër të sigurimit të përgjegjësive ndaj palës së tretë.

Figura 37. Asetet e sektorit të sigurimeve, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

¹⁰ ROAA dhe ROAE për vitin 2015 janë të aktualizuara me performancën e sektorit deri në shtator 2015.

Deri në shtator 2015, sektori i sigurimeve regjistroi humbje në vlerë prej 3.1 milionë euro, krahasuar me humbjes prej 1.0 milionë euro të vitit paraprak. Sigurimi jo-jetë vazhdon të karakterizohet me humbje krahas performancës pozitive financiare të sigurimit jetë. Deri në shtator 2015, sigurimi jo-jetë kishte humbje prej 3.4 milionë euro (fitim prej 351.5 mijë euro deri në shtator 2014), krahasuar me sigurimin jetë i cili regjistroi profit në vlerë prej 286.5 mijë euro deri në shtator 2015 (617.3 mijë euro deri në shtator 2014).

Performanca financiare e sektorit ndikoi në përkeqësimin e mëtutjeshëm të indikatorëve të profitabilitetit siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA u përkeqësua në -2.8 përqind (-0.2 përqind në vitin 2014) kurse ROAE në -8.2 përqind (-0.7 përqind në vitin 2014).¹¹ Sa i përket likuiditetit të kompanive të sigurimeve, indikatorët kyç shënuan rënie. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave teknike qëndroi në 108.2 përqind në shtator 2015 (119.1 përqind në shtator 2014), kurse raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve qëndroi në 93.6 përqind (105.0 përqind në shtator 2014).

Sektori pensional vazhdoi të shënojë rritje të asetëve si rezultat i arkëtimit të kontributeve të reja, mirëpo u karakterizua me kthim negativ në investime si rrjedhojë e zhvillimeve në tregjet e jashtme. Sektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje të kreditimit

dhe rritje të profitit si rezultat i përmirësimit të të hyrave. Sektori i sigurimeve, përkundër rritjes së aktivitetit, u karakterizua me performancë më të dobët financiare kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve për dëmet e ndodhura.


Tregu i letrave me vlerë

Sipas kalendarit të publikuar nga Ministria e Financave, gjatë periudhës janar-shtator 2015 janë mbajtur 16 ankande për emetimin e letrave me vlerë, nga të cilat njëmbëdhjetë (11) për emetimin e bonove të thesarit dhe katër (4) për emetimin e obligacioneve qeveritare. Në këto ankande të letrave me vlerë janë emetuar 295.5 milionë euro vlerë nominale, krahasuar me 302.2 milionë euro vlerë nominale emetuar në periudhën e njejtë të vitit të kaluar.

Shuma e emetuar e letrave me vlerë në formë të obligacioneve për periudhën janar-shtator 2015 është rritur në 84.95 milionë euro nga 37.0 milionë sa ishte në periudhën e njejtë të vitit të kaluar. Krahas rritjes së emetimit të obligacioneve, emetimi i bonove të thesarit tregoj rënie nga 265.17 milionë euro në 213.6 milionë euro deri në shtator 2015. Kjo gjë reflekton orientimin e Ministrisë së Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës drejt zgjerimit të afateve të maturimit ku edhe për herë të parë këtë vit janë emetuar dy obligacione qeveritare me afat maturimi 3 dhe 5 vjeçar. Sidoqoftë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej shumën e emetuar nga janari në shtator 2015 e kanë bonot e thesarit me maturitet 364 ditë (figura 38).


¹¹ ROAA dhe ROAE të anualizuara me performancën e sektorit deri në shtator 2015

Figura 38. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 39. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Që nga themelimi i tregut të letrave me vlerë në vitin 2012, shumën e ofertuar vazhdimisht ka tejkaluar shumën e shpallur në ankandë nga Departamenti i Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave. Raporti në mes të shumës së ofertuar dhe asaj të shpallur në ankandë për periudhën nga janari deri në shtator 2015 ishte 1.48 herë më i lartë. Ky rezultat tregon interesim të subjekteve pjesëmarrëse kryesisht sektorit bankar që tentojnë të zhvendosin investimet drejt instrumenteve në tregun e brendshëm në kushtet kur mundësitë për investime në letra me vlerë të qeverive të huaja janë më të kufizuara si rezultat i normave të ulëta mbizotëruese në këto tregje.

Pavarësisht kërkesës së lartë norma e përgjithshme mesatare e interesit në letrat me vlerë, në periudhën janar-shtator 2015 ishte lehtësisht më e lartë (1.98 përqind) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraparak (1.42 përqind). Kjo e ndikuar nga emetimi i letrave me vlerë të maturimeve më afatgjata konsideruar edhe emetimin për herë të parë të obligacioneve 3 dhe 5 vjeçare (figura 39).

Citimi i sygjeruar i këtij publikimi:

BQK (2015): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 12 TM3 2015, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2015):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,129>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,163>

ASK (2015):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit, qasur në nëntor 2015: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit, qasur në nëntor 2015: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit, qasur në nëntor 2015: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike, qasur në nëntor 2015: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat ë tregtisë së jashtme, qasur në nëntor 2015: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2015): Metal Prices database, qasur në nëntor 2015.

FAO (2015): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: qasur në nëntor 2015: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2015): Euribor Historical Rates, qasur në nëntor 2015:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2015): World Economic Outlook: qasur në nëntor 2015:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2015/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Shtator 2014	Shtator 2015
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	-	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	0.5%	-0.6%
Çmimet (fondi i periudhës)	1.3%	-1.3%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat (në milionë euro)	963.8	1,039.6
Shpenzimet (në milionë euro)	978.7	1,038.8
Bilanci, si përqindje e PBB-së	-14.8	0.8
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	4,457.0	4,771.2
prej të cilave: Bankat	3,149.5	3,321.4
Kredi	1,855.0	1,993.3
Depozita	2,518.0	2,656.5
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	10.7	7.9
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.1	0.9
Hendeku i normës së interesit	9.7	7.0
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-276.3	-324.0
prej të cilave: remitencat e pranuar	505.8	568.8
Llogaria financiare	-37.6	-152.4
Investimet e huaj direkte në Kosovë	121.7	260.7
Investimet portfolio, net	112.7	54.1
Investimet tjera, net	-69.2	-76.8
Pozicioni ndërkombëtar i Investimeve, net*	328.4	159.0
Asetet	4,117.8	4,342.6
Detyrimet	3,789.4	4,183.6
Borxhi i jashtëm, gjithsej	1,648.3	1,813.1
Borxhi i jashtëm privat	1,266.4	1,412.1
Borxhi i jashtëm publik	381.8	400.9

Burimi:

1/ ASK (2015).

2/ MF (2015).

3/ BQK (2015).

*Për PNI dhe borxhin e jashtëm, të dhënat janë deri në qershor.

